



Informata dhe udhëzime për Prindërit që flasin gjuhë të huaj

Të dashur Prindër

A mendoni ndonjëher, a duhet Ju me fëmijën tuaj edhe mëtutje të flitni në gjuhën amtare, edhe pse gjuha e rrethit është gjuha gjermane?

Jeni të mendimit se Ju me fëmijën tuaj, në fakt duhet të flitni gjermanisht, që ata në shkollë të dijnë këtë gjuhë?

Që Ju ti ndihmoni fëmijut Tuaj të mësoj gjuhën e dytë gjermanishten, është mirë ti respektoni këto rregulla:

- **Bisedoni me fëmijun Tuaj në gjuhën amtare**
Fëmijtë njëkohësisht menjëherë ose njëra pas tjetrës mund të mësojnë disa gjuhë, nëse ata në këta gjuhë duhet të përkrahen. Me rëndësi është, që Ju me fëmijën Tuaj të flitni në gjuhën tuaj amtare. Kjo i jep fëmijut një bazë të mirë për mësimin e gjuhëve tjera. Nëse fëmiju u Juaj më shpesh vjen në kontakt me gjuhën gjermane, atëherë fillon që në shtëpi më shpesh të flet gjermanisht. Këta faza janë më se normale. Por Ju rregullisht flitni me atë në gjuhën Tuaj amtare. Kështu fëmiju i Juaj nuk do ta harroj gjuhën amtare dhe më vonë me siguri ai këtë gjuhë edhe do ta flasë.
- **Ndihmoni fëmijun Tuaj gjatë mësimin të gjuhës amtare**
Bisedoni me fëmijun Tuaj në gjuhën amtare gjatë aktiviteteve të përditëshme shtëpiake si gjatë gatimit ose renditjes. Luani me fëmijun Tuaj, bashkërisht shfletoni të ilustruarat dhe tregoni fëmijut Tuaj përralla. Mësoni atij këngë dhe vjersha për fëmijë nga atëdheu. Ndërmerrni diçka bashkërisht dhe bisedoni me atë për përjetimet. Dëgjimi dhe kënaqësia gjatë të treguarit janë parakushte të rëndësishme për mësimin e një gjuhe.
- **Mundësoni fëmijut Tuaj, që para nisjes në Çerdhen e fëmijve, kontakt intenziv me fëmijtë që flasin gjuhën gjermane**
Kontakt i hershëm me gjuhën e rrethit gjegjësisht me gjuhën gjermane, mund të realizohet, si psh. Në kopshtin dhe grupin e lojrave, jepni pra fëmijut Tuaj më shumë kohë të adaptohet me këtë gjuhë. Ftoni shokë të fëmijut Tuaj tek ju, kështu i mundësoni atij më mirë ti përshtatet gjuhës gjermane – parakusht i rëndësishëm për nisjen e tij në Çerdhen e fëmijve ose në Shkollë.

Sot dihet se bazë e mirë është që një fëmijë në zhvillimin e tij të përgjithshëm të ndihmohet gjatë mësimin të një gjuhe – e kjo nuk është patjetër të jetë gjuha gjermane. Ai i cili ndihet i sigurtë në gjuhën e vet amtare, aktivisht do të kërkojë të kuptoj edhe një gjuhë tjetër. Dituria e më shumë se një gjuhe është pasuri në jetë dhe profesion.

Ju dëshirojmë knaqësi gjatë përdorimit të gjuhëve të ndryshme.

Logopedët e Shërbimit logopedik Linthgebiet

www.logopaedie-linthgebiet.ch

Maj 2010

Quelle:

- Triarchi-Herrmann, V.: Mehrsprachige Erziehung: Wie Sie Ihr Kind fördern. München: Reinhardt Verlag, 2003.

- Flyer: www.ifp-bayern.de